



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.46/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesuese, Skender Çoçaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 18.01.2025, merr këtë:

VE N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa Anr.46/2025 e datës 16.01.2025, e parashtruar nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025.

A r s y e t i m

Me datë 16.01.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesën Anr.46/2025, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, (LVV), me të cilën pretendon se më 16 janar 2025, në qytetin e Podujevës është vërejtur poster i kandidatit për deputet Qëndrim Softolli, nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës – LDK, të vendosur në hapësirat publike.

Sipas parashtruesit të ankesës, me këtë veprim Subjekti Politik LDK, ka bërë shkelje të nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës - LZP.

Si provë parashtruesi i ankesave kanë paraqitur një fotografi që dëshmon vendosjen e posterit në kundërshtim me LZP.

Më datë 18.01.2025, PZAP-i, e njoftoi Subjektin Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për ankesën e parashtruar kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje.

Në përgjigjen në ankesë të Subjektit Politik LDK, thuhet se pretendimet në ankesë nuk qëndrojnë, sepse në këtë rast kandidati Qëndrim Softolli, nuk ka bërë shkeljen e nenit 34 paragrafi 2 i LZP-së, me rastin e vendosjes së posterit, sepse i njëjti në hapësirën ku e ka vendosur posterin, ushtron biznesin e tij të cilin e ka në shfrytëzim që nga viti 2003.

Më tej në përgjigje në ankesë thuhet se objekti në të cilin është vendosur posteri, është i ndërtuar nga familja Sortolli dhe se konsiderojnë se ky veprim nuk cenon ndonjë nga dispozitat ligjore të LZP-së, ankesës i ka bashkangjitur Kontratën mbi Shfrytëzimin e Përkohshëm të Tokës Ndërtimore në Pronësinë Shoqërore, e lidhur më datë 28.03.2003.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga Subjekti Politik LDK, vlerësoj se pretendimet e Subjektit Politik LVV, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku parashihet se *“Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose ndryshe që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronareve ose shfrytëzuesve.”*

Kjo për faktin se parashtruesi i ankesës i referohet shkeljes së dispozitës ligjore të lartcekur, mirëpo paneli në bazë të shkresave të bashkangjitur në përgjigje në ankesë në këtë rast, konkretisht në Kontratën mbi Shfrytëzimin e Përkohshëm të Tokës Ndërtimore në Pronësinë Shoqërore, vërtetoi se posteri i kandidatit për deputet Qëndrim Softolli nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës – LDK, është vendosur në pronën private respektivisht në biznesin e tij.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: *“vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtruesi i ankesës nuk paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e refuzoi si të pabazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.46/2025 më datën 18.01.2025



